

Pershendetje i nderuar Kryetar i Komunes se Gjilanit,
I nderuar kryesues anetare dhe ish-anetare te KD,
I nderuar rektor, te nderuar prorektor, dekane.
I nderuar Sekretar,
Staf akademik e administrativ,
E nderuar Familje Zeka dhe familje te deshmoreve
te nderuar musafir te pranishem, media.
Te dashur e te nderuar studente.

Jam e nderuar qe sot ju drejtohem ne emer te studenteve dhe per kete do te mundohem te sjelle zerin e tyre ketu!

Duke pare rendesine qe studimet kane ne jeten e gjithesecilit, kam patur deshiren dhe per fat te mire mundesine qe kete periudhe ta kaloj duke bere perpjekje per avancim personal e kolektiv. Pavaresisht rrjedhave te ndryshme, nje titull te tille qe per mua ka qene shume me rendesi ne kohen kur ende nuk isha ne vendin ku jam sot, kenaqesia dhe eksperienca, sigurisht qe eshte e cmuar sot dhe do te jete edhe me e cmuar neser.

Sidoqofte dallimet e te qenit nje studente, dhe studente ne perfaqesim, me shume bindje po e them qe jane te pakrahasueshme.

Deshira dhe vullneti per te marre dije dhe avancuar ne jeten profesionale si pjese e studimeve ishte ne nivelet me te larta dhe e tille mbeti deri kur u ballafaqova me realitetin e te qenit studente ne perfaqesim ne kete Universitet.

Pavaresisht te gjitha peripecive qe per kohen ishin sfiduese, keto ndjenja pozitive kishin konsistence dhe po tregojne se i kane qendruar kohes.

Problemet per te cilat ne fillim me jane dukur si te zgjidhshme dhe ndoshta jashte kuadrit per te qene probleme te kohes kur po jetojme dhe shekullit ne te cilin

jemi, kane bere qe perspektiva e te qenit vetem nje studente, te merr nje kahje tjeter, ate te perfaqesimit te zerit e studenteve, pa te cilet sigurisht se Universiteti nuk do ekzistonte.

Se bashku me koleget kemi arritur te identifikojme dhe adresojme shume probleme prej te cilave ka ende qe nuk kane marre pergjigjet qe ne besojme se cdo student i ketij Universiteti i meriton, ku nder me kryesoret paraqitet mungesa e nje Kampusi, i cili edhe pse eshte premtuar te realizohet qofte nga Ministrat paraprak qofte nga ky menaxhment qe po permylle mandatin e dyte udheheqes, ende nuk eshte as ne fazat e para te planifikimit dhe zhvillimit te tij. Uroj qe te pakten fajtorin per kete ta keni gjetur meqe ky ishte edhe thelbi i diskutimeve qe kam pare e degjuar ne disa raste!

Problem tjeter e qe eshte thelbesor eshte rekrutimi i nje stafi te mirefillte akademik, duke pare nder vite eksperiencat e kaluara neper sallat e ketij Universiteti dhe nivelet e ligjeratave dhe ushtrimeve me te cilat studentet kryejne studimet, sigurisht se krahas Kampusit, nje ndryshim tjeter jetik per nxjerrjen e gjeneratave te suksesshme dhe te gatshme per tregun e punes, do ishte edhe permiresimi i stafit akademik, me shume pak raste te perjashtuara qe jane model si mesimdhenes e qe per fat te keq nuk po gjejne rrugen e duhur per ne katin e dyte te Universitetit!

Lajmet e "rezultateve" dhe "arritjeve" te ketij Universiteti shpeshhere jane ne kundërshtim te ndjeshem me realitetin qe studentet hasin ne perditshmerine e tyre universitare.

Kjo tregohet edhe ne "progresin" e shenuar ne matjet e ndryshme, si dhe e verteta me e dhimbshme paraqitet me mungesen e interesimit te studenteve per te u bashkuar ne studime, duke pare qe numri i te interesuarve ne pothuajse secilen njesi akademike eshte ne renje e siper, pa plotesuar as edhe numrat baze qe njesite akademike hapin per pranim te studenteve te rinj. Per kete natyrisht se emigrimi nuk eshte shkaku por thjeshte nje pasoje e radhes!

Natyrisht se sot kremtojme dhe keto qe sapo permenda kane vetem nje qellim te vetem, pra avancimin e perhershem te UKZ-se, Parlamenti Studentor perkunder gjitha sfidave e pengesave qe pati nga individe e grupe e shenoi pervjetorin e 9te per te treguar se datelindja e Universitetit eshte feste per Studentet!

Pra te nderuar, ne emrin e PS, KS Rinise Studentore Kadri Zeka dhe gjithe studenteve urime datelindjen e Universitetit me shprese qe cdo pervektor ta gjeje ukz-ne gjithnje e me mire!

Ju falemnderit!